

KONTROLLI I METALEVE

Përshkrimi i kursit


Prania e metaleve në ujin e pijshëm, edhe pse nuk përbën një rrezik shëndetësor për konsumatorët, bën që uji të jetë estetikisht i papërshtatshëm për konsum. Metalet e tepërta në ujë ndikojnë në zvogëlimin e prurjes në tubacione, dhe rritjen e presionit në sistemin shpërndarës.



Ky kurs ka për qëllim të trajtojë pjesëmarrësit në metodat e kontrollit të hekurit dhe manganit. Të diskutojë çështjet e zbutjes së ujit me anë të hidroksidit të kalciumit, karbonatit të natriumit dhe shkëmbimit jonik. Si dhe, do të fokusohet në metodat e kontrollit të korrozionit të jashtëm dhe të brendshëm në tubacione.

Kush duhet të marrë pjesë

Ky kurs është hartuar për profesionistët e shoqërive ujësjellës kanalizime dhe është veçanërisht i vlefshëm për inxhinierët që punojnë në impiantet e trajtimit të ujit të pijshëm, inxhinierët e prodhimit dhe laborantët.



Objektivat e kursit të trajnimit

Në fund të këtij kursi trajnimi, ju do të jeni të aftë të:

- Kuptoni pse rritet niveli i hekurit dhe manganit, dhe rëndësinë e kontrollit të tyre;
- Identifikoni proceset operationale të impianteve të trajtimit të ujit të pijshëm për largimin e hekurit dhe manganit;
- Shpjegoni fortësinë e ujit dhe avantazhet e zbutjes së tij;
- Përshkruani proceset e përdorura për zbutjen e ujit;
- Përshkruani zbutjen e ujit me anë të shkëmbimit jonik;
- Përcaktoni kur nevojitet mirëmbajtja, dhe të analizoni dhe zgjidhni problemet;
- Përzgjidhni dozimin e duhur kimik për kontrollin e korrozionit;
- Zgjidhni problemet që lidhen me korrozionin.

Metoda e trajnimit

Trajnimi është i bazuar në leksione të prezantuara në Power Point, të ndërthura me diskutime dhe raste studimore. Përveç marrjes së leksioneve dhe diskutimeve, pjesëmarrësit do të analizojnë edhe raste konkrete studimore.

Materialet e kursit të trajnimit

Si pjesëmarrës në këtë kurs, ju do të pajiseni me Manualin e Trajnimit "Kontrolli i Metaleve". Përpos kësaj, ju do të pajiseni me certifikatë e cila dëshmon pjesëmarrjen tuaj në këtë trajnim.

Tarifa e regjistrimit

Anëtarët e SHUKALB/SHUKOS: 22,000 lekë për person

Jo-anëtarët: 25,000 lekë për person

Kjo tarifë përfshin materialet e kursit, drekat, dhe pushimet për kafe.